



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Capital Sh.a nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a

Në datën 13 Janar 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të marrëveshjes së shitjes së aksioneve, të nënshkruar ndërmjet palëve (AVEL Sh.p.k për shitësin dhe Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a për blerësin) me objekt përftimin e kontrollit të shoqërisë Capital Sh.a nga Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a nëpërmjet transferimit të 51% të aksioneve në zbatim të Ligjit Nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a : ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimit dhe risigurimin e jetës, në përputhje me Ligjin Nr. 8081 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe në përputhje me licencimin nga organi perkatës (AMF-ja);
- Capital Sh.a: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikimin) për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al